



Në mbështetje të nenit 64.2 pika (a) dhe (b) dhe nenit 128.2 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), si dhe nenit 29.2 të Ligjit nr.03/L072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (LZL), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datën 09.03.2023, miraton këtë:

RREGULLORE NR. 13/2023

PËR REZULTATET PRELIMINARE

Neni 1

Fushëveprimi

Kjo Rregullore përcakton veprimet për procesin e raportimit të rezultateve dhe statistikave preliminare të zgjedhjeve.

Neni 2

Raportimi preliminar i rezultateve të zgjedhjeve

1. Raportimi preliminar përfshinë publikimin e rezultateve dhe statistikave për nivelin për të cilin mbahen zgjedhjet.
2. KQZ grumbullon të dhënat për rezultatet dhe statistikën të përmbledhura nga secili Komision Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) brenda komunës përkatëse.
3. KQZ përmes stafit të angazhuar për raportim, mbledh të dhënat përmes aplikacionit online nga të gjitha vendvotimet (VV), për pjesëmarrjen në zgjedhje dhe rezultatet preliminare të subjekteve politike, të shënuara në formularët e përputhjes së të dhënave dhe rezultateve (FPR)
4. Rezultatet preliminare përfshijnë vetëm votat e subjekteve politike nga VV e rregullta, pa përfshirë votat nga zarfet e fletëvotimeve me kusht, votat e personave me nevojë të veçanta dhe votat me postë.

Neni 3

Përgatitjet paraprake

1. KQZ bën përgatitjen e udhëzuesve dhe formave për raportim për KKZ në lidhje me raportimin, sipas paragrafit 2 të nenit 2, të kësaj Rregulloreje.
2. KQZ përmes KKZ angazhon staf për raportimin e rezultateve në të gjitha qendrat e votimit (QV).

3. Stafi për raportim trajnohet dhe pajiset me teknologji informative (TI), me udhëzuesin për raportim dhe nënshkruajnë kodin e mirësjelljes.
4. Më qëllim të mbarëvajtjes së procesit të raportimit në ditën e zgjedhjeve, sipas udhëzimeve, stafi kryen simulime të procesit të raportimit para ditës së zgjedhjeve. Simulimi duhet të përfshijë futjen e përnjëhershme të të dhënave në masë jo më pak se 60% të QV.

Neni 4

Raportimi në ditën e zgjedhjeve

1. KQZ publikon në uebfaqen e saj pjesëmarrjen në zgjedhje dhe rezultatet preliminare:
 - 1.1. Pjesëmarrjen e votuesve në zgjedhje në gjashtë intervale kohore: në ora 09:00, 11:00, 13:00, 15:00, 17:00, 19:00, përveç në rastet kur vendoset ndryshe nga KQZ;
 - 1.2. rezultatet e subjekteve politike dhe statistikat, pas përfundimit të numërimit në vendvotim.

Neni 5

Raportimi i pjesëmarrjes

1. Raportimi i pjesëmarrjes në zgjedhje, varësisht nga lloji i zgjedhjeve, duhet të përfshijë të dhëna për pjesëmarrjen në zgjedhje në nivel vendi, komune, QV dhe VV.
2. Informatat për pjesëmarrje në zgjedhje përfshijnë të dhënat si vijon:
 - 2.1. Numrin e votuesve në listën përfundimtare të votuesve;
 - 2.2. numrin e VV;
 - 2.3. numri i votuesve që kanë votuar;
 - 2.4. numri i VV të procesuara, nga të cilat janë dërguar të dhënat;
 - 2.5. pjesëmarrja në zgjedhje si përqindje e votuesve të cilët kanë votuar nga numri i përgjithshëm i votuesve në VV që janë procesuar.
3. Në raportimin e fundit të orës 19:00, paraqiten statistikat e pjesëmarrjes në bazë të gjinisë dhe grup-moshave.

Neni 6

Raportimi i rezultateve

1. Në zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, raportohen rezultatet e të gjitha subjekteve politike të certifikuara dhe të prezantuara në fletëvotim në nivel vendi, komune, QV dhe VV.

2. Në zgjedhjet lokale, raportohen rezultatet e subjekteve politike për kuvende komunale dhe rezultatet e kandidatëve për kryetar të komunave. Të dhënat prezantohen në nivel komune, QV dhe VV.
3. Rezultatet e prezantuara duhet të përfshijnë:
 - 3.1. Numrin e votave të vlefshme për secilin subjekt politik;
 - 3.2. përqindjen e votave të fituara të secilit subjekt politik, në raport me totalin e votave të vlefshme.

Neni 7

Paraqitja dhe prezantimi

1. Paraqitja dhe prezantimi duhet të bëhet në mënyrë jo diskriminuuese për subjektet politike.
2. Paraqitja vizuale duhet të përfshijë formën hartografike të komunave, ku pas klikimit në komunë prezantohen të dhënat e komunës përkatëse.
3. Për secilin subjekt politik duhet të vendoset një ngjyrë e caktuar, e cila e prezanton subjektin në paraqitjen grafike dhe duhet të ketë kontrast të mjaftueshëm, për të bërë dallimin e ngjyrave të subjekteve.
4. Në një vend të dukshëm duhet të paraqitet sqarimi se rezultatet preliminare nuk përfshijnë votat me kusht, votat me postë dhe votat e personave me nevoja të veçanta.

Neni 8

Verifikimi dhe kontrollimi

1. Pas publikimit të rezultateve dhe statistikave preliminare, KKZ bën kontrollimin e rezultateve të publikuara, duke i krahasuar me të dhënat që KKZ i proceson nga kopjet e Formularëve të Përputhjes së të Dhënave dhe Rezultateve (FPR).
2. KQZ bën korrigjimin e të dhënave sipas njoftimit për korrigjim të pranuar nga KKZ përmes ZLKZ.

Neni 9

Dispozitat përfundimtare

Pjesë përbërëse e kësaj Rregullore është procedura për raportimin e rezultateve preliminare.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi